

PKR.nr.425/15

NË EMËR TË POPULLIT

REPUBLIKA E KOSOVËS - GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga kryetari i trupi gjykues – gjyqtari Naser Foniqi, me procesmbajtësen Sevdije Breznica, në çështjen penale të akuzuarit, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275, par. 1, të KPRK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda PP.nr.6945/12, të datës 08.05.2013, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 01.08.2018, në të cilin ishte e pranishme vetëm Prokurorja e shtetit Ferdane Sylejmani, pas shqyrtimit fillestar, të njëjtën ditë, me datë 01.08.2018, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M**Ndaj të akuzuarit**

V.S., i biri i Xh. dhe Sh., e vajzërisë M., i lindur me datë ..., në fshatin B., Komuna P., ku edhe jeton, me numër personal ..., shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363 par. 1, nënpar.1.1 të KPPK.

REFUZOHET AKUZA

S e p s e: në mënyrë të pa autorizuar ka poseduar narkotik të llojit marihuanë, ashtu që me datë 02.04.2010, rreth orës 21:44 në P. në rr. “A.A.”, pasi është ndaluar nga Policia e Kosovës, gjatë kontrollit të tani të akuzuarit kanë gjetur substancë narkotike të llojit marihuanë, e cili pas ekzaminimit është vërtetuar se është e llojit kanabis (marihuanë), e cila përmban tetrahidrokanabinol (THC), në peshë të përgjithshme prej 1.93 gram,-

- me çka, kishte për të kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275, par. 1, të KPRK,
- **pasi që prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza.**
- Nga i akuzuarit si më lart, konfiskohet substanca narkotike kanabis (marihuanë) Tetrahidrokanabinol (THC), në peshë totale 1.93 gram, e cila është përdorur për kryerjen e veprës penale.
- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A R S Y E T I M I

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP.nr.6945/12, të datës 08.05.2013, e ka akuzuar të pandehurin V.S., për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, nga neni 229, par. 1 të KPK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të datës 01.08.2018, pas konstatimit se mungon i akuzuari, për të cilin akoma nuk është kthyer fletë dërgesa, me të cilën do të konstatohet nëse i njëjti e ka pranuar thirrjen ose jo, prokurorja e shtetit ka kërkuar fjalën dhe ka deklaruar se duke u bazuar në nenin 3 par. 2 të KPRK, ku parashihet se në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm, e në rastin konkret duke u bazuar në këtë dispozitë si ligj më i favorshëm është Kodi Penal i Republikës së Kosovës, ashtu që ka bërë ri cilësimin nga vepra penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, nga neni 229, par. 1 të KPK, në veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275, par.1 të KPRK, për të cilën parashihet dënimi me gjobë dhe me burgim prej 1 deri 3 vjet, e meqenëse vepra penale është kryer me datën 02.04.2010, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, pasi që nga kryerja e veprës penale kanë kaluar më shumë se 6 vite, përkatësisht ky parashkrim ka arritur me datë 02.04.2016. Pastaj, prokurori i shtetit në bazë të nenit 52, të KPPK është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të pandehurit V.S., për veprën penale të ri cilësuar, dhe për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Pasi që Prokurori i shtetit, është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të pandehurit V.S., për shkak të veprës penale, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata në bazë të nenit 363, par. 1, nënpar. 1.1, të KPPK, refuzoi aktakuzën si në hyrje të këtij aktgjykimi.

Vendimi që të pandehurit t'i konfiskohet substanca narkotike e sekuestruar nga policia, e paraqitur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, u mor në bazë të nenit 275 par.3, të KPRK.

Vendimi për shpenzimet procedurale u mor në bazë të nenit 454, par. 1, të KPPK.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 363, par. 1, nënpar. 1.1, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 01.08.2018.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.425/15, datë 01.08.2018.

Sekretare juridike,
Sevdije Breznica

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari,
Naser Foniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.